

— K. V., Çistov, (Moskva), *Probleme bashkëkohëse të folkloristikës sovjetike*. Problemet e folkloristikës sovjetike, sipas autorëve dalin nga këta faktorë kryesorë: 1) ndërliqshmëria e përbërjes etnike e BRSS, 2) funksioni internacional i folkloristikës sovjetike dhe 3) transformimi social dhe kulturor i shoqërisë sovjetike. Në vijim kemi edhe tri punime: Juzef Burshta (Poznanj), *Studimet polake të folklorit ballkanik — të Oskar Kolbergut dhe Kazhimjezh Moshinjskit*; V. K. Bondarçik — A. S. Fedosik (Minsk), *Bazat shkencore të botimit shumëvëllimësh të folklorit belorus*; Ksenija Siharulidze (Tbilisi), *Studimi krahasues i poezisë agrare gruziane*.

Në rubrikën „Kumtesa” jepen tetë kumtesa të shkurta rreth temash të ndryshme, ekskluzivisht të folklorit maqedon, madje prej autorësh të vendit, maqedonë. Këto kumtesa shqyrtojnë tema të ndryshme: *Balada maqedone sot*, *Përmbajtja e këngës maqedone gjatë tri gjeneratave*, *Folklori në veprat e Vasil Iloskit, Kraj*

Marku humb fuqinë, Profeti Jeremia në traditën popullore, Kallëzime të mbledhura prej Marko Cepenkov, Doket dhe lojnat rusale në fshatin Sekirnik, Karakteristikat muzikore të këngëve të kremtës Vodice në Poreç.

Në rubrikën „Materiale” kemi dy kontribute të vogla: *Bërja e martinës* (një lloj nuske) dhe *Këngët llazore të Drimkollit*. Në këtë të fundit jepet një numër i madh këngësh interesante. Pas rubrikës „Kritika, recensione dhe shënime”, brenda së cilës jepen 25 kritika e recensione për vepra dhe revista të ndryshme të vendit dhe nga jashtë, kemi kronikën e ngjarjeve, të tubimeve folkloristike dhe etnografike dhe, në fund, bibliografinë.

Padyshim që edhe ky numër i kësaj reviste na jep të kuptojmë se në RS të Maqedonisë po i kushtohet kujdes i madh folklorit, krijimtarisë popullore të maqedonëve.

KADRI HALIMI

NARODNA KNJIŽEVNOST (izbor studija i članaka o narodnoj književnosti) priredili: Dr. Đenana Buturović i Dr. Vljako Palavestra, „Svjetlost”, Sarajevo 1974, f. 286.

Në këtë përmbledhje studimesh dhe artikujsh mbi letërsinë gojore të regjionit të të folurit sërbo-kroatish, përpiluesit Dr. Gjenana Buturović dhe Dr. Vljako Palavestra kanë përfshirë 31 punime të 23 autorëve. Vëllimin — LETËRSIA GOJORE e kanë ndarë në dy pjesë: Poezia popullore (24 punime) dhe proza popullore (7 punime). Janë këto studime, artikuj, vështrime, punime me karakter informativ-shpjegues dhe asish me elemente të recensio-nit.

Në parathënien e shkurtë përpiluesit pohojnë, pos të tjerash, se qëllimi i tyre ka qenë të prezantojnë ato punime mbi letërsinë gojore (autorët herë përdorin termin letërsi popullore e herë letërsi gojore) të regjionit të të folurit sërbo-kroatish (sërbëve, kroatëve, muslimanëve dhe malazezëve), që paraqesin shkallën e arritur në punën shkencore-hulumtuese, përfundimet e të cilave punime, në një mënyrë ose në një tjetër, i kanë pranuar shumica e hulumtuesve, sidomos sa i përket bazës së tyre teorike. Në qoftë se mbështetemi në këtë dhe në të dhëna të tjera, si dhe në vetë punimet e botuara, mund të thuhet, në pika të përgjithshme, sa vijon:

1. Duke i parashtruar vetes si detyrë të përfshijnë në përmbledhje artikuj, që

bëjnë fjalë kryesisht për traditën letrare gojore që krijohet te sërbët, te kroatët, te muslimanët dhe te malazetët, përpiluesit kanë qenë të detyruar të lënë anash disa artikuj analitikë, që bëjnë fjalë për probleme të përgjithshme të krijimtarisë letrare gojore të popujve që jetojnë në Jugosllavi, me një anë, dhe, duke dashur herë-herë të përgjithësojnë traditën letrare të regjionit të të folurit sërbo-kroatish, kanë përfshirë artikuj, ku bëhet fjalë dhe për letërsinë gojore jugosllave, dmth. është përfshirë letërsia gojore sllovene, maqedone dhe ajo që krijohet në Vojvodinë, sikur është rasti me punimin e V. Nediqit për lirikën popullore jugosllave, ai i Vido Llatkoviçit mbi klasifikimin e letërsisë gojore jugosllave, në anën tjetër.

2. Disproporcioni sasior i artikujve, që bëjnë fjalë për poezinë dhe për prozën gojore (edhe pse përpiluesit e arsyejnë me të dhënë se s'ka artikuj të mjaftë mbi prozën), është i paarsyeshëm. Ndonëse numerikisht ka më shumë artikuj mbi poezinë gojore, prapëseprapë ka pasur mundësi të zgjedhen edhe disa artikuj të tjerë mbi aspektet dhe llojet e ndryshme të prozës gojore. Për një gjë të tillë bindemi në qoftë se e shfletojmë librin „Bibliografija radova o narodnoj književnosti”, autorë: M.

Bogovac, V. Maksimović, L. Šekara, Sarajevo 1972 ose disa nga revistat që botojnë artikuj të këtyllë e që janë më të vonshëm se viti i botimit në fjalë. Këtu po përmendim vetëm artikullin e Pero Slipçevićit mbi anekdotat popullore (për këtë lloj mjaft të përhapur dhe të rëndësishëm të krijimtarisë gojore në prozë nuk bëhet fjalë në këtë përmbledhje), që nuk është përfshirë në vëllim.

3. Në një mënyrë ose në një tjetër përmbledhjes në fjalë i mungon koncepti i mbarështrimit, qoftë sa i përket llojit dhe karakterit të punimeve, qoftë sa i përket tematikës së tyre. Kështu, fjala vjen, pas artikullit hyrës mbi lirikën gojore jugosllave, bëhet fjalë për bugarshticat, pastaj për fytyrën epike të Kralëviq Markut e diku nga mesi për dy përmbledhjet e Vuk Karaxhiqit, për këngëtarët, krijues të këngëve popullore apo mbi klasifikimin e letërsisë gojore, mbi çështjet terminologjike (në artikujt e V. Llatkoviçit dhe të R. Medenicës). Ose në mes të punimeve analitike vihet punimi me elemente të recensionit, sikurse është ai i J. Jagiqit. etj.

4. Duke mos përfillur, fjala vjen, ndarjen në artikuj tematikë dhe tematikë mbi letërsinë gojore të regjionit të të folurit sërbo-kroatish, përpiluesit kanë qenë të detyruar që disa punime, që bëjnë fjalë, edhe për poezinë, edhe për prozën, t'i vejnë në pjesën e artikujve që bëjnë fjalë për poezinë! (Sidomos ai i V. Llatkoviçit mbi klasifikimin e letërsisë gojore jugosllave).

5. Fitohet përshtypja se përpiluesit e kësaj përmbledhje kanë përfshirë dhe një numër artikujsh pa cilësinë e punimeve të njëmendëta shkencore. Një numër punimesh janë të karakterit informativ-shpjegues, si fjala vjen, ai mbi këngëtarin, plakun Milijen. Disa nga punimet janë shkurtuar e disa të tjerë janë fragmente të studimeve më të gjata dhe shpesh nuk lënë përshtypjen e tërësisë.

6. Përpiluesit duke qenë punëtorë nga Sarajeva, kanë përfshirë një numër më të madh artikujsh që bëjnë fjalë për traditën letrare gojore të muslimanëve të Bosnës dhe të Hercegovinës, vështruar nga aspekte të ndryshme.

Punimeve të përmbledhjes i prin ai i Vlladan Nediçit — *Jugoslavenska narodna lirika* (Lirika popullore jugosllave), në të cilin janë theksuar disa nga veçoritë dhe cilësitë e lirikës së popujve të Jugosllavisë dhe

të llojeve të saj. Edhe pse artikulli ka tërësinë e vet, ka elemente të dukshme të metodës pozitiviste të interpretimit dhe të studimit të fenomeneve letrare të poezisë, që bartet gojë me gojë. Punimin e karakterizon më tepër cilësia informativ-shpjeguese se sa shkoqitëse dhe analitike. Në punimin: *Balada o Marku Kraljeviću i bratu mu Andrijašu* (Balada mbi Kralëviq Markun dhe vëllain Andrijashin) Maja Boshkoviç-Stulli shtron problemin e bugarshticave. Në të vërtetë, duke bërë fjalë për këtë baladë, si bugarshticën e parë të shënuar, vë në pah se ky lloj krijimi poetik është i traditës gojore, për të cilën gjë dëshmojnë shumë elemente, si ato stilistiko-gjuhësore, struktura e vargjeve, formulat, që zakonisht shprehen përmes antitezës, epitetit tipike të poezisë gojore, fenomeni i deminutivit të emrave, gërshetimi i të folmeve etj.

Punimi vijues është ai i Salko Nazeçiqit — *Epski Kraljević Marko*, në të cilin janë vënë në pah disa dimensione epike dhe historike të kësaj fytyre. Autori konsideron se këngët që bëjnë fjalë për Kralëviq Markun në shërbim të sulltanit si delibash, kanë ruajtur elemente më të vjetra dhe janë më afër të dhënave historike, ndërsa në këngët e tjera fytyra e këtij trimi është epiko-legjendare. Nazeçiq pohon se kjo fytyrë është krijuar dhe skalitur në këngë me shumë detaje dhe paraqet personazhim më të kompletuar të epikës gojore sllave. Punimi i Vatroslav Jagiqit — *Kosovski junaci i dogadjaji u narodnoj epici. Napisao Dr. T. Maretić. U Zagrebu 1889*. (Trimat e Kosovës dhe ngjarjet në epikën popullore. Shkruar nga Dr T. Maretiq. Në Zagreb 1889), kalon kufijtë e recensionit të zakonshëm, dhe, me një frymë polemizuese, shtron problemin e epikës gojore sërbo-kroate. Jagiq pohon se ky lloj i traditës gojore letrare të sërbet dhe të kroatit u zhvillua herët, në kohën e krijimit të veçorive etnike të këtyre popujve. Në mënyrë kategorike ai mohon mendimin e Maretiqit se kinëse këngët popullore sërbo-kroate për ngjarjet e Luftës së Kosovës, janë krijuar dhe kënduar pas shekullit XV.

Pa ndonjë vlerë të veçantë dhe pa të dhëna të shumta është punimi i Miroslav Pantiqit — *Narodne pesme u zapisima XV—XVIII veka* (Këngët popullore në shënimet e shek. XV—XVIII). Problemi i identifikimit të disa personazheve të epikës gojore muslimane të Bosnës me të dhënat historike, sidomos rreth fytyrës së Hans Kacianerit (Katzianer) — është shtruar në punimin e studjuesit Alojz Shmausit (Alios Schmaus) — *Prilozi instraživanju*

južnoslovenske epike (Kontribut rreth hulumtimit të epikës jugore sllave). Autori në mënyrë analitike bën krahasimin e dokumentave të shumtë historikë dhe të dhënave që dalin nga disa këngë të dorëshkrimit të Erlangenit.

Studjuesi amerikan, Albert B. Lord, njohës i mirë i traditës gojore sllave e sidomos i asaj muslimane, në punimin — *Uticajturskih osvajanja na Balkansku epsku tradiciju* (Ndikimi i pushtimit turk në traditën epike të Ballkanit) ka prekur disa nga çështjet e rëndësishme të lindjes dhe të zhvillimit të epikës gojore në Ballkan dhe ka theksuar disa nga karakteristikat kryesore të saj. Autori vë në dukje se pushtimi turk ndikoi dukshëm në traditën gojore, në tregimin, në baladën dhe në disa këngë të tjera, kryesisht të shkurta, që gradualisht filluan të shndërrohen në poezinë epike. Në mënyrë të veçantë Lordi ka shkoqitur disa nga veçoritë e epikës gojore muslimane (ai mundohet të përcaktojë dhe shtrirjen gjeografike të saj) dhe marrëdhëniet me traditën epike të popujve të krishterë në Ballkan. Duke bërë krahasimin e këtyre traditave, autori thekson se epika gojore muslimane ka ruajtur më shumë elemente mitike se sa ajo e krishterë, tek e cila vërehen elemente të lidhjes me ngjarje historike. Në këtë punim janë bërë dhe krahasime mes këngëve epike muslimane dhe Odisesë së Homerit, problem të cilin autori e ka studjuar gjerësisht në veprën — *The Singer of Tales (Këngëtarit rrëfen)* Cambridge, Mass., 1960.

Njëra nga autorët, përpilues të përmbledhjes, Gjenana Buturoviq, është prezentuar me punimin — *Najstarija svedočanstva o narodnim pjesmama bosansko-hercegovačkih Muslimana* (Dokumentet më të vjetra mbi këngët popullore të muslimanëve të Bosnës dhe Hercegovinës). Artikulli është shkruar me kujdes dhe ka plot të dhëna të argumentuara mbi zhvillimin historik të traditës gojore letrare të muslimanët e Bosnës. Në mënyrë të veçantë, autorja thekson kontributin e udhëpërshkruesit turk, Evlia Çelepi, i cili jep të dhëna me interes të madh rreth gjendjes së traditës gojore letrare në Bosne në vitet 1660 dhe 1664. Në artikullin — *Narodna epska pjesma u Crnoj Gori* (Kënga popullore epike në Mal të Zi) Vido Llatković thekson se, ndonëse nga regjioni i ngushtë i Malit të Zi deri në shek. XIX nuk ekzistojnë këngë popullore të regjistruara, kjo nuk do të thotë, në asnjë mënyrë, se ky popull nuk e kishte të zhvilluar edhe më parë traditën

epike gojore. Disa këngë, që bëjnë fjalë për Iva Černojeviqin dhe Sulltan Mehmetin (1461) etj., dëshmojnë për ekzistimin më të hershëm të një tradite të këngës epike popullore.

Luftrat e cubave rreth Dubrovnikut dhe kënga popullore — *Hajdučke borbe oko Dubrovnika i naša narodna pjesma*, është problemi që ka shtruar Salko Nazeçiq. Në të bëhet fjalë për shkaqet e cubnisë në relacionin: kënga si krijim letrar dhe të dhënat historike. Në fragmentin e Alojz Shmausit — *Studije o Krajinskoj epici* (Studime mbi epikën e Krajinës) në vija të përgjithshme përmenden disa nga problemet që duhet të jenë objekt i studjuesve të ardhshëm të epikës gojore të Krajinës, sidomos të asaj muslimane.

I qartë, i shkruar me kujdes dhe analitik është punimi i autores Hatixha Kër-njeviqit — *Hasanaginica* (Kontribut për studimin e baladave gojore), në të cilin bëhet fjalë për vlerat artistike dhe për analizën e disa aspekteve dramatike dhe psikologjike të personazheve të këtij krijimi poetik gojor. Autorja konsideron se ngjarja e kësaj balade esencialisht është e kushtëzuar nga konflikte të një natyre të jashtëzakonshme. Ato janë të dyfishuara dhe si rezultat i transformimeve psikologjike të personazheve. Konflikti i brendshëm i tyre zbulon konfliktet e veçanta të Hasanagës dhe të Hasanagicës. Baladën e karakterizon dinamizmi i kushtëzuar nga serioziteti i konfliktit, ritmi i emocioneve, drama e brendshme e njeriut. Në fund të punimit, autorja vë në dukje se kjo baladë është poezi e zjarrtë njerëzore. „Ajo i kalon kufijtë e natyrës së njeriut, mposht shprishjen e vetvetes dhe krejt çka është rreth vetes.”

Në vazhdim janë përfshirë tre artikuj të Vlladan Nediqit: — *O prvoj i drugoj Vukovoj Pjesnarici* (Mbi „Pjesnaricën” e parë dhe të dytë të Vukut), *Starac Milija* (Plaku Milia), dhe *Pjevanija Sime Milutinovića Sarajljije*, që janë të lidhura ngushtë me problemet e historisë së letërsisë gojore sërbe. Punimi i Svetozar Matiqit — *Višnjic u Sremu* (Vishnjqiqi në Srem) kalon kufijtë e një punimi të zakonshëm mbi një këngëtar sikur është Vishnjqiqi, nga i cili Vuku mbledhi një numër të konsiderueshëm këngësh popullore. Autori trajton disa probleme që kanë të bëjnë me mënyrën e krijimit dhe të interpretimit të këngëve, të varianteve dhe të këngëtarëve, si krijues të këtyre krijimeve.

Matija Murko në punimin — *Epska narodna poezija u Jugoslaviji početkom XX vijeka* (Poezia epike popullore në Jugo-

slavi në fillim të shek. XX) jep të dhëna me interes për gjendjen dhe zhvillimin e traditës gojore epike në Jugosllavi, për llojet e këngëve, për mënyrën e të kënduarit, për këngëtarët etj. Shprehja letrare artistike në krijimet gojore sërbo-kroate dhe disa probleme të tjera, që janë të lidhura me mënyrën e krijimit dhe të interpretimit të epikës gojore — janë objekt i punimit të Vojislav Gjuriqit — *Srpskohrvatska narodna epika* (Epika popullore sërbo-kroate), ndërsa interpretimi stilistiko-linguistik i një vjershe të shkurtë lirike, vështruar nga l) rëndësia e intonacionit të rrokjeve dhe b) roli i strukturës së fjalive dhe i intonacionit të tyre (i vetmi i këtij lloji në këtë përmbledhje), është bërë mjaft qartë dhe me mjeshtri në punimin e Jovan Vukoviqit — *Stilistička analiza jedne srpskohrvatske narodne lirске pesme* (Analiza stilistike e një vjershe lirike popullore sërbo-kroate).

Rreth disa karakteristikave tematiko-motivore, vlerave estetiko-letrare, zanafillës si dhe ndryshimeve që kanë pësuar sevdalinket dhe shkaqet që tani ky lloj i poezisë gojore në Basne ka filluar të zbehet (Sevdalinket u krijuan dhe u zhvilluan në kohën e feudalizmit), bëhet fjalë në punimin e Hamza Humos — *Sevdalinka na rubu dvaju društvenih sistema* (Sevdalinka në kufi të dy sistemeve shoqërore), ndërsa struktura liriko-psikologjike e tyre është shtruar në studimin e Muhsin Rizviq — *O lirsko-psihološkoj strukturi sevdalinke*. Autori, pos të tjerash, vë në dukje se për kah karakteri poetik, sevdalinket ngapak kanë esencën baladeske, tragjikën e errët dhe ndjenjat e dhimbshme. Këto krijime, sipas tij, janë monolog i femrës që në planin emocional-subjektiv përcjell ngjarjet nëntekstuale në rrjedhën abstrakte; monolog i ndjenjave personale si rezonancë dhe komentim i dashurisë dhe i jetës.

Tvrtko Çubeliq në punimin — *Stilsko-izražajne karakteristike narodnih pjesama iz razdoblja narodne revolucije* (Karakteristikat stilistike-shprehëse të këngëve popullore nga periudha e revolucionit popullor) bën fjalë për veçoritë ideore, tematike, gjuhësore-estetike të këngëve, kushtuar revolucionit. Autori konstaton se është e nevojshme që, poezia gojore mbi revolucionin popullor të kuptohet si tip i ashtuquajtur *poezi ekstrate* (funksionale), ku të gjitha mjetet shprehëse dhe artistike i janë nënshtruar funksionit themelor dhe idesë themelore. Vido Llatkoviq në punimin e vet — *Klasifikacija jugoslovenske usmene književnosti* (Klasifikimi i letërsisë gojore jugosllave) ka për objekt një çështje të rëndësish-

me të traditës gojore letrare. Autori mendon se ndarja klasike në: lirikë, epikë dhe dramatikë, nuk mund të gjejë zbatimin në ndarjen dhe klasifikimin e llojeve të krijimtarisë letrare gojore jugosllave, prandaj ai dallon këto gjini: tregimet, këngët lirike dhe këngët epike. Ato lloje, që nuk përfshihen në këto tri grupe, duhet të përfshihen në krijimet e shkurta dhe të studjohen si të veçanta. Këtë çështje, bashkë me atë të terminologjisë, e shtron dhe Radoslav Medenica në punimin — *Prilog pitanju klasifikacije i terminologije narodnih pesama* (Kontribut çështjes së klasifikimit dhe terminologjisë së këngëve popullore), me të cilin punim madje mbyllet pjesa që bën fjalë për poezinë gojore. Pjesa e dytë — *Proza popullore*, fillon me studimin e Maja Boshkoviq-Stullit, — *Narodne pripovijetke* (Tregimet popullore), ku shkoqiten disa cilësi të tregimit, të llojeve të tij, të terminologjisë, të klasifikimit etj. Problemi i fundit, klasifikimi, është studjuar dhe nga Tvrtko Çubeliq në punimin — *Klasifikacija narodnih pripovjedaka* (Klasifikimi i tregimeve popullore). Duke pasur parasysh kompozicionin e tregimeve popullore, Çubeliq i ndanë në katër grupe kryesore: 1. Përralla, 2. Legjenda, Gojëdhana, 3. Novela, Anekdotë, 4. Novela mbi kafshët, Përrallëza, duke theksuar disa nga karakteristikat e secilit lloj. Në artikullin e Nada Millosheviq-Gjorgjeviq — *Bogati Gavan* (Gavani i pasur) bëhet fjalë për legjendat dhe gojëdhënat e kësaj teme me prejardhje fetare. Autorja jep të dhëna të mjaftueshme, për të dëshmuar se kjo legjendë është përhapur mjaft në poezi dhe në prozë dhe se ndikimi reciprok i njërit lloj në tjetrin është i dukshëm, por jo kurdoherë i qartë se cili ka ndikuar në tjetrin.

Problemi shtruar më rrallë është ai në punimin e Milenko S. Filipoviqit — *Lokalna predanja — zanemarena vrsta usmene književnosti* (Gojëdhënat lokale—lloj i letërsisë gojore i lënë pasdore), ku autori thekson se përkundër faktit se gjojëdhëna lokale ka rëndësi për studime sociologjike, historike dhe kulturele për të kaluarën, ajo, para së gjithash, duhet të mblidhet dhe të studjohet si lloj i krijimtarisë letrare gojore. Një lloj konkretizimi i çështjes, që ka shtruar Filipoviq, është punimi i autorit Vlajko Pallavestra — *Narodna predanja o starom stanovništvu u Dinarskim krajevima* (Gojëdhëna popullore mbi banorët e vjetër në viset Dinarike). Punimi — *O narodnim govornim tvorevinama* (Mbi krijimet gojore popullore) i Milivoje V. Knezheviqit bën fjalë për llojet minorë të

letërsisë gojore — shprehjeve, thëniet, fjalëve të urta, pyetjeve etj. Përmbledhja mbyllet me punimin e Miodrag S. Llalleviqit — *Zagonetka igrarija duha* (Kashelashi lojë argëtuese e shpirtit), ku autori bën fjalë për prejardhjen e emrin e kashelashit, për gjenezën, për formën dhe për

disa karakteristika të tjera si krijim letrar gojor.

Në *Vërejtje* janë dhënë shënimet e burimeve, nga janë marrë studimet dhe artikujt e botuar në këtë përmbledhje.

ANTON BERISHA

Blaže Ristovski, MAKEDONSKI NARODNOOSLOBODITELNI PESNI, Skopje 1974, 80, f. 90. Botim i Institutit të Folklorit Shkup.

Ky botim i veçantë në sendorësi përfaqëson një përmbledhje të shkurtë këngësh maqedone të Luftës Nacionalçlirimtare, këngë, të cilat, në flakën e revolucionit tonë, u mbarështruan, redaktuan dhe botuan prej poetit të shquar maqedon, Koço Racin. Këto këngë ishin shtypur në muajin maj të vitit 1943 në shtypshkronjën ilegale, me të cilën dispononte baza ilegale e Shtabit Kryesor të UNÇ të Maqedonisë në malin Llopushnik. Shkrimtari Koço Racin ishte caktuar nga Shtabi Kryesor dhe nga Komiteti Qendror i PKM redaktor dhe lektor i të gjitha materialeve që shtypeshin prej udhëheqësisë partiake dhe ushtarake të Maqedonisë. Kështu, Koço Racin kishte pregaditur dy përmbledhje të vogla këngësh të LNÇ. Të parën me gjithsej 20 këngë e shtypi sa që vetë gjallë, ndërsa të dytën, vetëm me 11 këngë, ia gjetën shokët në trastë, pasi u vra, dhe e botuan.

Tani Instituti i Folklorit i Shkupit, duke pasur parasysh rëndësinë historike të këtij edicioni këngësh të LNÇ, në të vërtetë të dyja ato përmbledhje i riboton në një ble të vetëm, kështu që kjo përmbledhje ka tash 31 këngë po me atë renditje që ka shtuar revolucionari Koço Racin. Mirëpo, tash përmbledhja është pajisur me një koment mjaft të hollësishëm, në fillim, me melograme e shënime bibliografike për këngët si dhe me një regjistër emrash dhe me rezyme në gjuhën frënge. Tërë këtë punë e ka bërë Dr. Blaže Ristovski.

Komenti, apo më drejt, analiza që i ka bërë Dr. B. Ristovski „Këngëve nacionalçlirimtare maqedone” të Racinit, ka mbështetje shkencore dhe është e bindshme. Së pari ai thotë se edhe këto këngë hyjnë në fondin e këngëve popullore maqedone mbi përpjekjet, kryengritjet dhe luftërat për çlirimin kombëtar të maqedonëve që nga vitet 1877—78 e deri më 1903, kur plasi Kryengritja e Ilindenit. Së dyti, Koço Racini ka qenë njohës i mirë i këngëve dhe i traditës revolucionare maqedone, ka njohur mirë momentin historik dhe në pajtim

me këtë ka bërë zgjedhjen e këngëve me vëmendje, në mënyrë që këto t'i përgjigjen çastit historik dhe aktualitetit të së tashmes.

Përmbledhjet e Koço Racinit kanë rëndësi të dorës së parë për gjuhën maqedone, për historinë e gjuhës, për formimin e gjuhës letrare. Sikundër u tha, Koço Racini ka qenë caktuar prej Komitetit Qendror të PKM jo vetëm si redaktor, por edhe si lektor i fjalës së shkruar dhe të shtypur nga udhëheqësia partiake e ushtarake e Maqedonisë. Me ardhjen e Racinit në bazën e Shtabit Kryesor fillon procesi i krijimit të gjuhës letrare maqedone dhe puna e tij përnjëmend paraqet unifikimin dhe normimin e parë të organizuar të gjuhës maqedone, kurse përmbledhjet përfaqësojnë librin e parë të literaturës së lirë maqedone.

Më pas, autori thotë se në këtë kohë ndër luftëtarët e UNÇ ka mbretëruar një atmosferë ekzaltimi, së këndejmi edhe këto përmbledhje janë një shprehje e gjendjes reale. Në këto këngë me një theks të veçantë potencohet çdo gjë që është maqedone. S'e gjejmë as një këngë, ku të mos zihet ngojë Maqedonia dhe maqedonët. Koço Racin dhe veprat e tij janë revolucionare. Për të s'ka qenë punë e vështirë të hartojë përmbledhje këngësh që do të paraqisnin kontinuitetin e traditës revolucionare, dhe që do të përfaqësonin një shprehje besnike të një faze të re të luftës maqedone për çlirimin kombëtar, dmth. të LNÇ.

S'është gjë e rastit pse Racini nuk i quan popullore këto këngë. Pos ca këngëve popullore, këtu kemi këngë të adaptuara, të autorizuara, këngë masovike, këngë luftarake e marshe, përkthime prej bullgarishtes dhe serbokroatishtes etj. Megjithatë, këto janë shprehje e frymës dhe e ndjenjave të popullit, kështu që populli i ka përqaftuar dhe në saje të kësaj, përmbledhja u bë „publikimi më popullor partizan”.

Sikurse u tha, këtu ka këngë të vjetra mbi luftën për çlirimin kombëtar, të cilat